KONTRATE THEMELIMI

Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare":

REXHEP UKPERAJ, i biri i Hamzes dhe i Fatmanes, lindur 7.06.1950, banues ne Krume te Hasit,

DEM GAXHA, i biri i Rexhepit dhe i Gjylshanes, lindur 1967, banues ne Krume te Hasit,

me cilesine e ortakeve te shoqerise tregtare :

NENI 1

Themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "VELLAZERIA "SHPK, me seli ne Krume te Hasit.

NENI 2

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte mbi 10 vjet.

NENI 3

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke, i formuar ne mase te barabarte nga te dy ortaket 50 000 leke per secilin.

NENI 4

Administrator i shoqerise eshte REXHEP UKPERAJ.

NENI 5

Objekti i veprimtarise eshte ne fushen e ndertimit, punime dheu, sistemime, tarracime terenesh; prodhime materiale inerte, rere, cakull, gure, mermer; prodhime elementesh te parafabrikuara, beton, beton arme; ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj deri dhe mbi dy kate; si dhe kompletime me instalimet e nevojshme per to; ndertime rruge, vepra arti te vogla deri 6 km; ndertime ujesjellsa e kanalizime; rikostruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash; mirembajtje zhvillime dekori ne mjedise urbane; tregtim me shumice dhe me pakice, import-eksport te materialeve te materialeve te ndertimit, elektrike lende drusore, elektronike, industriale , ushqimore, mineralesh si dhe

- % - RU Dem Gaxha

transportimin e mallrave brenda dhe jashte vendit.

NENI 6

Secili ortak para se te heqe dore nga shoqeria do te njoftoje ortakun tjeter ne afatin e percaktuar me ligj.

NENI 7

Secili ortak mund te ngarkoje nje person te trete per ta perfaqesuar ne drejtimin dhe administrimin e pjeses se tij ne kuoten e kapitalit.

NENI 8

Mosmarreveshjet mund te zgjidhen me mireku tim ose ne rruge gjyqesore ne Gjykaten e rrethit Tirane.

NENI 9

Kjo kontrate u redaktua ne kater kopje me vlera te njejta.

ORTAKET THEMELUES

REXHEP UKPERAJ

DEM GAXHA

## S T A T U T

I

shoqerise tregtare "VLLAZERIMI "SHPK

THEMELIMI

NENI 1

Ortaket REXHEP UKPERAJ dhe DEM HAXHA kane themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar ,emertimin "VELLAZERIMI"SHPK.

SELIA

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Krume te Hasit.
Ajo mund te cele edhe qendra te tjera brenda dhe jashte vendit.

AFATI

NENI 3

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte mbi 10 vjet.

OBJEKTI

NENI 4

Shoqeria do te ushtroje veprimtari ne fushen e ndertimit,punime dheu,sistemime,tarracime terenesh;prodhime materiale inerte,rere,cak ell,gure,mermer;prodhime elementesh te parafabrikuara,beton arme dhe beton;ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore etj,deri dhe mbi dy katesh;si dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to; ndertime rruge,vepra arti te vogla deri ne 6 km;ndertime ujesjellsa e kanalizime;rikonstruksione godina civile e ekonomike;veshje fasa- dash;mirembajtje zhvillim deko ri ne mjedise urbane;tregtimin e ma llrave me shumice dhe me pakice,omport-eksport te materialeve te ndertimit,elektrike.lende drusore,elektronike,industriale,ushqimore mineralesh si dhe transportimin e mallrave brenda ose jashte vendit.

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin,seline objektin e kapitalin

me vendim te asamblese se ortakeve.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke i formuar ne mase te barabrate nga te dy ortaket 50 000 lek secili,teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket.

Ne kete mase do te jete edhe ndarja e fitimeve ose humbjeve.

NENI 7

Kapitali themeltar mund te shtohet por jo te pakesohet me vullnetin e te dy ortakeve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 8

Organ vendimor i shoqerise eshte asambleja e ortakeve.

Aty vendoset per ndryshimet ,per shtimin e ortakeve dhe te kapitalit,per shtimin e veprimtarise etj.

NENI 9

Vendimet e marra ne asamblene e ortakeve jane te detyrueshme per zbatim nga te punesuarit ne kete shoqeri.

NENI 10

Vendimet dhe diskutimet per marrjen e tyre evidentohen ne procesverbalet ,qe nenshkruhen prej te dy ortakeve.

NENI 11

Ortaket kane keto te drejta:

_ Marrin pjese ne administrimin e drejtimin e shoqerise

_ Marrin pjese ne rezultatet e shoqerise sipas kontributit,ne kapital

_ Shprehin propozime dhe mendime ne asamblene e ortakeve.

_ Njihen me te dhenat per gjendjen ekonomike e financiare te shoqerise si dhe dokumentet ku evidentohen veprimet e saj.

- % -

NENI 12

Ortaket kane keto detyrime:

- Te depozitojne kuoten e themelimit te kapitalit te shoqerise.
- Te japin te dhenat e domosdoshme ekonomike e financiare te dokumenteve qe kane te bejne me mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise
- Te kryeje detyrat e ngarkuara nga asambleja e ortakeve.

NENI 13

Secili ortak ka te drejten e heqjes dore nga shoqeria ne cdo kohe me detyrimin per te njoftuar ne afatin e percaktuar me ligj per largimin,duke paraqitur edhe propozimin per shitjen e kuotes se tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 14

Secili ortak qe largohet nga shoqeria nuk shkarkohet nga detyrimet qe ka ndaj shoqerise ose detyrimet e shoqerise ndaj tij.

NENI 15

Administrator i shoqerise eshte REXHEP UKPERAJ.

MARREDHENIET EKONOMIKO FINANCIARE

NENI 16

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper detyrime brenda kapitalit te saj themeltar.

NENI 17

Shoqeria eshte prone e te dy ortakeve themelues te saj.

NENI 18

Shoqeria mund te cele llogari ne leke ose valute ne bankat shqiptare ose te huaja,shteterore ose private,brenda ose jashte vendit.

NENI 19

Shoqeria ka te drejten e tjetersimit perdorimit dhe disponimit te pasurive te veta ne perputhje me qellimin e veprimtarise se saj.

Rulyp Devrecel

PERFAQESIMI

NENI 20

Perfaqesimi i shoqerise i perket te dy ortakeve te shoqerise.

MAREDHENIET E PUNES

NENI 21

Maredheniet e punes me te punesuarit ne kete shoqeri rregullohen sipas ligjeve ne fuqi e Kodit te Punes.

NENI 22

Me te punesuarit lidhet kontrate pune individuale dhe kolektive ne te cilen percaktohet paga,koha e punes dhe leoji i punes.

NENI 23

Shoqeria mund te punesoje persona fizike shqiptare dhe te huaj.

NENI 24

Madhesia e shperblimit te punonjesve nuk kufizohet por ajo nuk mund te jete me ulet nga c'percaktohet nga organet perkatese

NENI 25

Shoqeria mund te lidhe kontrate me shoqeri te tjera,private dhe shteterore,brenda dhe jashte vendit.

NENI 26

Mosmareveshjet zgjidhen me vullnetin e paleve me mirekuptim ose me rruge gjyqesore ne Gjykaten e Tiranes.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 27

Veprimtaria financiare e shoqerise mbeshtet ne bilancin fitim-humbje.

Ajo fillon diten e regjistrimit ne Gjykaten e Tiranes per vitin e pare dhe me 1 janar te cdo viti dhe mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti

- % -

NENI 28

Llogaria kontabel dhe ajo ekonomike mbahet ne seline e shoqerise.

NENI 29

Ne fund te periudhes ushtrimore nxirret bilanci .

Bilanci miratohet nga asambleja e ortakeve,

NENI 30

Pas vecimit te fondeve te akumulimit,te pagesave te punonjesve te detyrimeve fiskale e sigurimeve shoqerore fitimi ndahet midis ortakev ve sipas kontributit ne kapitalin themeltar.

SHPERBERJA

NENI 32

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cdo shkak

NENI 33

Asambleja e ortakeve vendos per likuidimin e pasurise se saj duke percaktuar nje ose disa likuidatore.

NENI 34

Likuidatoret jane pergjegjes per pasurine e shoqerise derisa ajo tu dorezohet te treteve ,duke shlyer me pare detyrimet ndaj te tretev

NENI 35

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet legjislacionit per shoqerite tregtare.

NENI 36

Statuti nenshkruhet prej ortakeve themelues te shoqerise.

REXHEP UKPERAJ DEM GAXHA

Tirane 11 dhjetor 1995